



SHOQATA PRO-EKSPORT ALBANIA

Nr. 87/2023 Prot.

Tiranë, më 22 Nentor 2023

Lënda: Pandemia ekonomike dhe mbrojtja e vendeve te punes.

Z. Ervin Mete

Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Z. Endrit Yzeiraj

Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Për dijeni:

Znj. Delina Ibrahimaj

Ministër Shteti për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit

I nderuar Zoti Ministër,

Shoqata “Pro-Eksport Albania” përfaqësuese e 840 bizneseve Fason/Manufakturë të veshjeve dhe këpucëve kërkon të shprehë shqetësimin e saj mbi një problematikë që po ndodh që nga fillimi i vitit 2023 me situatën e vështirë dhe si pasojë mbyllet ose ngadalësimin e gjithë zinxhirit prodhues në fabrikat tona.

Sektori Manufakturë i veshjeve dhe këpucëve po kalon një situatë shumë alarmante siç edhe Ju jeni në dijeni me rënie të theksuar të porosive/prodhimet për eksport (të dhënat Instat muaji **Gusht 2023 -21,9%** në krahasim me muajin **Korrik 2023, -12.8%** në **Shtator 2023** krahasuar me **Shtator 2022** dhe **-11,2% në Tetor 2022** krahasuar me **Tetor 2023**), kursi i këmbimit, rritja e kostove, mungesë e theksuar likuiditeti, amortizimi i impianteve prodhuese e një mori problematika të tjera që ky sektor ka, flasim për Manufakturën/Fason të veshjeve dhe të këpucëve që zë mbi 38% të eksporteve Made in Albania (për vitin 2022) dhe mbi 75.000 të punësuar.

Bizneset prodhuese të sektorit tashmë kanë filluar të reduktojnë linjat prodhuese e disa të tjerë kanë filluar mbylletjen e bizneseve, pasi kostot deri në pritje të ndryshimit të

PRO-EKSPORT ALBANIA

Cel:00355/698364328

Email: kryetari@fason.al

Web: www.fason.al

Adresa: Rruga Reshit Collaku, Ndertesa n° 38 - Kati i 3 (Trete)- Hyrja n°1/Ap. n°3
Tirane, Shqiperi



situatës janë të larta dhe kjo ka çuar deri më sot që bizneset të rrisin borxhin që kanë me DPT-n dhe Bankat e nivelit të 2.

Duke vënë theksin me sa parashtruar më sipër, perceptimi që bizneset e sektorit tonë kanë është lënia të vetëm dhe ndalimi pa asnjë arsye apo force madhore të vazhdimit të dialogut dhe gjetjen e zgjidhjeve.

Shkaku dhe mendimi ynë po i rendisim si më poshtë:

- Situata e eksporteve që nga Marsi 2023 me rënie dyshifrore në disa muaj dhe që shkaku kryesor është rënia e pajustificuar e Euros ose forcimi i çuditshëm i lekut dhe që nuk përkon me rritjen ekonomike ku në tre mujorin e parë rritja 2.7% më e ulëta mbas pandemisë është treguesi më kokëfortë se shumë gjëra nuk shkojnë.
- Indiferenca e MFE-s dhe BSH-s gjatë gjithë këtyre muajve dhe anashkalimi i problematikave, pavarësisht apelit të PEA-s në rrugë zyrtare dhe të gjithë eksportuesve, të dhënat e pakontestueshme të INSTAT që si shkak kryesor paraqesin rënien e Euro si dhe mungesën e perspektivës për të ardhmen, janë shkaqe që agravojnë në kurriz të bizneseve.
- Përkeqësimi i klimës së biznesit duke mos dëgjuar thirrjen e PEA-s me anë të një letre të shoqëruar me një studim për zgjidhjen e kësaj situatë (studimi i bërë në bashkëpunim me ekspertët më të mirë brënda dhe jashtë vendit të politikave monetare dhe fiskale dorëzuar që në fillim të muajit Shtator 2023) si dhe anashkalimit total të dialogut me biznesin për konsultimin e projekt buxhetit dhe paketës fiskale 2024, tregojnë errësirën dhe destabilizon çfarëdo biznes plani që një biznes mendon për të ardhmen e tij.

Kërkohet nga ana Juaj :

1. Marrja në kosideratë dhe reagim nga ana Juaj të letrës drejtuar Kryeministrit Z. Rama, MFE-s, BSH-s, Komisioneve Parlamentare të Ekonomisë dhe atij të Prodhimit.
2. Vazhdimi i dialogut për zgjidhjen e situatës si dhe parandalimin e situatave të ngjashme në të ardhmen.
3. Vendosja e paketës Manufakturë të propozuar nga PEA e cila do të mundësonte orientimin dhe kalimin e sektorit në prodhues konkret Made in Albania.

PRO-EKSPORT ALBANIA

Cel:00355/698364328

Email: kryetari@fason.al

Web: www.fason.al

Adresa: Rruga Reshit Collaku, Ndertesha n° 38 - Kati i 3 (Trete)- Hyrja n°1/Ap. n°3
Tirane, Shqiperi



Sektori ka një peshë të rëndësishme në ekonomi, në punësim dhe eksporte, kërkohet sensibilizimi i Institucioneve përgjegjëse por mbi të gjitha për të mbajtur të ndezura makineritë prodhuese dhe për të ruajtur vendet e punës e për të mos patur impakt social në të ardhmen e afërt.

Pandemia ekonomike që ka kapluar sektorin adresohen vetëm tek problemet tona të brendëshme dhe si të tilla ka hapësirë e mundësi të minimizohen kur ekziston dëshira për ta ndalur.

Me respekt dhe besimin se do të merren në konsideratë.

Pro-Eksport Albania
Sektori Ekonomik

PRO-EKSPORT ALBANIA
Cel:00355/698364328
Email: kryetari@fason.al
Web: www.fason.al

Adresa: Rruga Reshit Collaku, Ndertesë n° 38 - Kati i 3 (Trete)- Hyrja n°1/Ap. n°3
Tirane, Shqipëri